

Data: 04.10.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirëmbajtje ashensorësh për Spitalin Universitar të Traumës”
për një periudhë 12 Mujore, - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha
kushtet janë të përcaktuara me afat 12 muaj**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbime për mirëmbajtjen e ashensorëve – 50750000-7

**VLERA E FONDIT LIMIT: 6,499,333.33 (gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë
mijë e treqind e tridhjetë e tre pik tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Universitar i Traumës** ka hartuar procesverbalin për
argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën
e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e ofertës sipas shtojcës 1

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM
nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Operatori ekonomik duhet të disponojë licencën zbatimi **NS 3-A** për montimin e impianteve ngritese dhe transportuese. Në përmbushje të kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën e zbatimit të shoqërisë.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë kërkuar *për të vërtetuar se operatori vepron sipas legjislacionit në fuqi dhe bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, gërma a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar, për tre vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros minimale vjetore për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Vlera prej 40% e fondit limit të kërkuar është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1. Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vlerës së fondit limit* për të cilat konkurren operatorit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku

të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e shërbimeve të ngjashme prej 20% të fondit të limit/ vlerës së pritshme të kontratave, të parashikuar, i jep siguri AK që operatorët kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.2. OE duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar prej prodhuesit (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të kryejë mirëmbajtjen/riparimin ose zëvendësimin e pjesëve të këmbimit të ashensorëve objekt i kësaj procedure prokurimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar.

Shënim: autorizimi kërkohet vetëm për ashensorët e rinj të cilët janë të instaluar në SUT mbas vitit 2019 dhe kërkojnë certifikim CE.

2.3.3. OE duhet të paraqesë një vetëdeklarim ku të garantohet furnizimi me pjesë këmbimi origjinale/ekuivalent të tyre për ashensorët që do të mirëmbahen/riparohen. OE duhet të deklarojë se pjesët që do të zëvendësohen do të jenë me një garanci për të paktën një vit.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar për të për të vërtetuar lidhjen e OE me prodhuesin ose distributorin e autorizuar, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe neni 40, pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021. OE duhet të sigurojë Ak se do të kryejë shërbimet/riparimet dhe furnizimet me pjesë këmbimi sipas katalogut të prodhuesit dhe legjislacionit në fuqi.*

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të provojë që ka të paktën **4 të punësuar** nga të cilët tre punonjës dhe një inxhinier mekanik i cili duhet të jetë Drejtues teknik sipas licencës përkatëse NS 3-A. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë listepagesen e muajit të fundit dhe kontratat e punës të vlefshme për 4 punonjësit, vetëdeklarim për aftësitë teknike apo çdo dokument provues për kualifikimet teknike të 3 punonjësve ndërsa për inxhinierin mekanik duhet të paraqitet edhe diploma përkatëse.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

1 (nje) inxhinier mekanik

3 (tre) punonjes

Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij 1 inxhinier mekanik dhe 3 punonjes është vendosur në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysh proceset përkatëse të shërbimit lidhur me mirëmbajtjen e ashensorëve dhe numrit të ashensoreve që kanë nevojë për shërbime.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Sipas shtojcës nr. 5 “Formulari i specifikimeve teknike” publikuar në DT.

Argumentimi: Specifikimet teknike të mësipërme janë përcaktuar përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, pika 3/a të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.